



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 3080/17 Prot.

Pogradec, më 18.12.2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Znj.MANJOLA KAMOLLI, KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt vendimin dhe relacionin shoqërues, për:

“Miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe të Buxhetit Vjetor 2025 të Bashkisë Pogradec”.

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 4

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

RELACION

PËR

**“ MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026 – 2028
DHE BUXHETIN VJETOR 2025, BASHKIA POGRADEC”**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, nenit 54, gërma “dh”, të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, nenet 33 e vijues të Kreut VII, të Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të rradhës do të shqyrtojë:

1. Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetin vjetor 2025 si më poshtë:
 - Jo më vonë se data 20.01.2025, 03-31 Janar 2025 Kryetari i Bashkisë paraqet në Këshillin Bashkiak raportin programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe të buxhetit vjetor 2025.
 - Këshilli i Bashkisë miraton raportin e vlerësimit jo me vone se data 1 Mars 2025 dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:
 - a) dy vitet para vitit buxhetor
 - b) vitin buxhetor
 - c) tre vitet e ardhshme buxhetore .
 - Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe transfertave të pakushtëzuara GMS dhe Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve përgatitin tavanet e shpenzimeve në nivel programi dhe Këshilli i Bashkisë miraton tavanet e shpenzimeve për PBA 2026-2028 jo më vonë se data 15 Mars 2025.
 - Kryetari i Bashkisë pas miratimit në Këshill të tavanëve përgatitore të shpenzimeve deri datë 15 Mars 2025 miraton udhëzimin e përgatitjes së PBA dhe e shpërndan tek njësitë shpenzuese në Bashki;
 - Programi buxhetor afatmesëm miratohet nga Këshilli i Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë;
 - Brenda datës 01 Qershor 2025 Kryetari i Bashkisë i dergon Ministrisë së Financave projekt dokumentin e PBA 2026-2028;
 - Brenda datës 20 Qershor 2025 Ministria e Financave përgatit një raport me mendime mbi projekt dokumentin e PBA;
 - Projekti së bashku me mendimet zyrtare të Ministrisë së financave i paraqitet Këshillit të Bashkisë dhe brenda datës 30 Qershor 2025, Këshilli miraton projektin e parë të PBA duke shprehur opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

- Brenda datës 05 Korrik 2025 Kryetari i Bashkisë merr masat për publikimin e dokumentit të parë të PBA;
- Bazuar në parashikimet e përditësuara të të ardhurave dhe transfertave, Kryetari i Bashkisë paraqet për miratim në Këshill tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA në nivel programi. Këshilli i Bashkisë miraton tavanet përfundimtare brenda datës 20 Korrik 2025;
- Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i tavanëve përfundimtare Kryetari i Bashkisë nxjerr udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit të bashkisë dhe e shperndan tek njësitë shpenzuese;
- Në muajt Gusht – Shtator pas finalizimit të PBA të rishikuar, Kryetari i Bashkisë bën publikimin e tij dhe organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit dhe proces verbalet e takimeve bëhen pjesë e dokumentit të PBA;
- Brenda 15 Shtator të vitit 2025, Këshilli i Bashkisë miraton PBA e rishikuar, Bashkia dërgon në Ministrinë e Financave PBA e rishikuar së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga MF gjatë fazës së parë;
- Brenda datës 5 Tetor, Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë vendore;
- Brenda datës 20 Tetor, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për tu reflektuar në dokumentin final të PBA
- Kryetari i Bashkisë brenda datës 30 Nëntor paraqet për shqyrtim dhe miratim projektin e PBA përfundimtare së bashku me mendimet e Ministrisë të Financave dhe vlerësimin e tij për marrje në konsideratë të tyre;
- Çdo anëtar këshilli mund të propozojë ndryshime të argumentuara të projekt-buxhetit të paraqitur nga kryetari.
- PBA 2026-2028 përfundimtare miratohet nga Këshilli i Bashkisë jo më vonë se data 25 Dhjetor 2025.
- Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i buxhetit në këshill, Kryetari merr masa për publikimin e tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të bashkisë
- Jo më vonë se 5 ditë nga miratimi i buxhetit vjetor, dërgohet në Ministrinë e Financave.

Konceptoi: Danjela Hafësllari

Pranoi: Irsa Karapança

Miratoi: Dritan Babasani

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.____.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____, DATË _____.____.2024

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028
DHE TË BUXHETIT VJETOR 2025 BASHKIA POGRADEC**

Në zbatim të pikës 2 të nenit 8, pikës 1.2 gërma "a" të nenit 9, nenit 54, gërma "dh", të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, nenet 33 e vijues të Kreut VII, të Ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli i Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Të miratojë Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 si dhe të Buxhetit vjetor 2025, si më poshtë:

Struktura Përgjegjëse	Veprimi përkatës	Periudha
Kryetari i Bashkisë dhe GMS	Hartimi dhe paraqitja për miratim në Këshillin Bashkiak i Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe të buxhetit vjetor 2025.	Jo më vonë se data 20.01.2025
Kryetari i Bashkisë	Shpërndarja e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor tek të gjitha njësitë shpenzuese të njësisë së qeverisjes vendore.	Pas miratimit në Këshillin Bashkiak.
Kryetari i Bashkisë, të gjitha Drejtoritë e Bashkisë, Institucionet e vartësisë dhe NJA.	Paraqitja e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor b) vitin buxhetor c) tre vitet e ardhshme buxhetore	Jo më vonë se data 31 Janar 2025
Këshilli i Bashkisë	Miratimi i raportit të vlerësimeve dhe të parashikimeve afatmesme të të ardhurave	Deri në datë 1 mars 2025
Kryetari i Bashkisë, GMS dhe	Përgatitja dhe paraqitja për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore i tavanëve	Deri në datë 15 mars



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEÇ
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

EMP	përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	2025
Këshilli i Bashkisë	Miratimi i taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.	Deri në datë 15 mars 2025
Kryetari i Bashkisë	Miratimi i udhëzimit të përgatitjes së buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarja tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Kryetari i Bashkisë, GMS dhe EMP	Përgatitja e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.	Gjatë muajit prill-maj 2025
Kryetari i Bashkisë	Dërgimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.	Brenda datës 1 qershor 2025
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizon dhe përgatit një raport me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.	Brenda datës 20 qershor 2025
Kryetari i Bashkisë	Paraqitja në Këshillin e Bashkisë të projekt dokumentit të programit buxhetor afatmesëm dhe mendimin zyrtar të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.	Brenda datës 30 qershor 2025
Këshilli i Bashkisë	Shqyrtim dhe miratim i projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm, duke shprehur dhe opinionin e tij për rekomandimet e Ministrisë së Financave.	Brenda datës 30 qershor 2025
Kryetari i Bashkisë, Këshilltari i Kryetarit për Marrëdhëniet me mediat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Publikimi i dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm të miratuar.	Brenda datës 5 korrik 2025
Kryetari i Bashkisë, GMS dhe	Përgatitja e taveve përfundimtare të programit	Brenda datës 15 korrik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

EMP	buxhetor afatmesëm në nivel programi.	2025
Këshilli i Bashkisë	Miratim i taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.	Brenda datës 20 korrik 2025
Kryetari i Bashkisë	Nxjerrja e udhëzimit plotësues për përgatitjen e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarja tek të gjitha njësitë shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të taveve të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Kryetar i Bashkisë, GMS	Pas finalizimit të projektit të dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për publikimin e tij. Organizon seanca dëgjimore me komunitetin dhe grupet e interesit.	Brenda datës 1 shtator 2025
Këshilli i Bashkisë	Paraqitja për shqyrtim dhe miratim i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar.	Brenda datës 15 shtator 2025
Kryetari i Bashkisë	Dërgim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë i dokumentit të programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjatë fazës së parë.	Pas miratimit nga Këshilli Bashkiak brenda datës 15 shtator 2025
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Zhvillimi i seancave të konsultimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore.	Brenda datës 5 tetor 2025
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA.	Brenda datës 20 tetor 2025
Kryetari i Bashkisë, GMS dhe EMP	Përgatitja e projekt programit buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe paraqitja për shqyrtim e miratim në Këshillin Bashkiak, së bashku me projektbuxhetin vjetor.	Jo më vonë se data 30 nëntor 2025
Këshilli i Bashkisë	Paraqitja për shqyrtim dhe miratim i programit buxhetor afatmesëm përfundimtar.	Jo më vonë se data 25 dhjetor 2025
Kryetari i Bashkisë, Këshilltari	Publikimi i dokumentit të plotë të programit	Jo më vonë se data 31



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E EKONOMISE DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

i Kryetarit për Marrëdhëniet me mediat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	buxhetor afatmesëm, përfshirë dokumentacionin shoqërues të tyre.	dhjetor 2025
Kryetari i Bashkisë, Këshilltari i Kryetarit për Marrëdhëniet me mediat dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	Publikimi i buxhetit vjetor përfshirë dokumentacionin shoqërues të tij në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të njësisë së qeverisjes vendore.	Jo më vonë se 15 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak
Kryetari i Bashkisë	Dërgim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të buxhetit vjetor 2025	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit të tij
Nëpunësi Autorizues	Pas miratimit të buxhetit vjetor nga Këshilli Bashkiak Nëpunësi Autorizues detajon fondet buxhetore për të gjitha njësitë shpenzuese dhe ua dërgon zyrtarisht njëjësive shpenzuese.	Jo më vonë se 5 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha Drejtoritë e Bashkisë Pogradec, Njësitë Administrative dhe të gjitha institucionet dhe ndërmarrjet në varësi të Bashkisë Pogradec.

4. Ky urdhër hyn në fuqi në datë __/__/2024

K R Y E T A R E

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 5080 / Prot
17

Pogradec, më 18.12.2024

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN
PËR

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2026-2028 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2025 BASHKIA POGRADEC”,**

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon: **“Akt normativ nënligjor”** është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

- a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;
- b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin e tij do të sjellë pasoja juridike duke sjellë efekte financiare në vazhdimësi, në Buxhetin e Bashkisë Pogradec.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE



KRYETAR

Ilir XHAKOLLI

